



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 561/2 Prot.

Tiranë, më 17.03 2026

**VENDIM**

Nr. 36 dt. 17 103 2026

**"PËR  
MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË OBJEKTIVAVE, NË UNIVERSITETIN E  
SPORTEVE TË TIRANËS, PËR VITIN 2026"**


Në mbështetje dhe në zbatim të pikës 1/b të nenit 38, të Ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë", të Statutit të UST, neni 20, të Vendimit të Rektoratit me nr. 38 datë 09/03/2026 "Për miratimin e propozimit të objektivave, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, për vitin 2026", Senati Akademik në mbledhjen e datës 17/03/2026,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë propozimin për objektivat në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin 2026, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Ky Vendim i përcillet për miratim Bordit të Administrimit.

**KRYETARË I SENATIT AKADEMIK**

**PROF. DR. AGRON KAS**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS  
ADMINISTRATORI

Nr. 277 Prot.

Tiranë, më 19.02 2026

**Lënda:** Dërgojmë për miratim objektivat e UST-së për vitin 2026.

**REKTORATIT TË UST-SË**


**KËTU**

Mbështetur në Vendimin e Senatit Akademik me Nr. 89 datë 01.08.2025 "Për propozimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të Universitetit të Sporteve të Tiranës për periudhën 2026-2031", në Vendimin e B.A. me nr. 42 datë 01.08.2025 "Për Miratimin e Planit Strategjik të Zhvillimit të UST, për periudhën 2026-2031", në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 90, datë 07.08.2025 "Për miratimin e propozimit të Programit Buxhetor Afatmesëm, periudhën 2026-2028 për Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin e B.A. nr. 44 datë 14.08.2025 "Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm për vitin 2026-2028 për UST", në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 1 datë 08.01.2026 "Për miratimin e propozimit e detajimit të Grantit të mësimdhënies për vitin 2026 të UST-së", në Vendimin Qarkullues të Bordit të Administrimit me nr. 1 datë 08. 01. 2026 "Për Miratimin e detajimit të Grandit të mësimdhënies për vitin 2026 të UST", në Vendimin e Senatit Akademik me nr. 12 datë 29. 01. 2026 "Për miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave të krijuara nga viti 2025 në Universitetin e Sporteve të Tiranës", në Vendimin nr. 6 datë 29.01.2026 "Për Miratimin e detajimit të të ardhurave dytësore të krijuara në UST për vitin 2025", në Akt-reakordinin e mbajtur mes UST dhe Degës së Thesarit të Tiranës për periudhën janar - dhjetor 2025, ju dërgojmë për miratim objektivat e Universitetit të Sporteve të Tiranës për vitin 2026.

Duke ju falenderuar,

**ADMINISTRATORI**

**Haxhirete SULAJ**



**OBJEKTIVAT E UNIVERSITETIT TË SPORTEVE TË TIRANËS PËR VITIN 2026**

**Misioni**

Misioni i UST-së është t'i shërbejë shoqërisë nëpërmjet arsimit, hulumtimit, inovacioneve; nxitjes së zhvillimit individual për transformimin e jetëve, sigurimin e suksesit të studentëve në një mjedis global, ofrimin e shërbimeve akademike dhe zhvillimin e një komuniteti të larmishëm dhe gjithëpërfshirës. UST-ë është një universitet publik me status të veçantë, që ofron gamë të plotë të programeve të nivelit bachelor, master dhe studime doktrale. Universiteti kontribuon në zhvillimin e shoqërisë, përmes tri shtyllave të misionit të arsimit të lartë publik: kërkim shkencor, edukim, si dhe shërbim ndaj publikut, që vazhdimisht e pasurojnë dhe e informojnë njëra-tjetrën. UST ofron edukim me në qendër studentin, si dhe nxit rritjen personale dhe intelektuale, për të përgatitur studentë për karriere produktive dhe qytetare, të përgjegjshëm në një shoqëri globale.

**UST-ë ka për mision:**

- a. formimin universitar të studentëve e të specialistëve në të tria ciklet e studimit;
- b. kualifikimin e punonjësve akademikë e shkencorë në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe të sporteve, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv dhe rehabilitimit;
- c. nxitjen e kërkimeve e të studimeve në fushën e edukimit fizik, shëndetësor dhe sportiv, veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv e rehabilitimit;
- d. thellimin e kualifikimit profesional e shkencor të specialistëve të lartë në këto fusha;
- e. ofrimin e shërbimeve për të tretët dhe konsulencë në fushën e veprimtarisë së veprimtarisë fizike, shëndetit, rekreacionit, turizmit, menaxhimit sportiv e rehabilitimit
- a. përgatitjen dhe stërvitjen e sportistëve elitare nëpërmjet ofrimit të metodave më të avancuara të teorive dhe praktikave të stërvitjes.

**QËLLIMI:** Përmirësimi cilësor i mësimdhënies dhe përvetsimit të dijeve në UST përmes përmirësimit të kurrikulave në të tre ciklet e studimit sipas ligjit të Arsimit të Lartë , përmirësimi i metodave të mësimdhënies nëpërmjet zhvillimit të burimeve njerëzore , ndërthurje e mësimdhënies me kërkimin shkencor , sigurimi i cilësisë , ndërkombëtarizimi etj.

<b>PRIORITETI STRATEGJIK 1: ZHVILLIMI INSTITUCIONAL</b>		
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
	<b>Objektivi i parë: Të transformohet struktura institucionale në funksion të përmbushjes së vizionit dhe misionit të institucionit.</b>	
1.1.1	Të riformësohet struktura institucionale për të përmbushur vizionin dhe misionin e fokusuar në fushën e sporteve, edukimit fizik, shëndetit dhe mirëqenies, bazuar në studimin e tregut.	2026
1.1.2	Të riformatohet struktura institucionale në përputhje me dokumentet e UNESCO-s dhe kuadrit legjislativ mbi Arsimin e Lartë.	2026
	<b>Objektivi dy: Organizimi dhe qeverisja efektive</b>	
1.2.1	Përgatitja e dokumenteve të politikave vijuese	2026-2031
1.2.2	Planifikimi i markës dhe identitetit strategjik.	2026
1.2.3	Plani i zhvillimit të infrastrukturës.	2026
1.2.4	Strategjia e internacionalizimit.	2026

1.2.5	Politika për zhvillimin e kurrikulave.	2026
1.2.6	Politika e sigurimit të cilësisë	2026
1.2.7	Politika e qëndrueshmërisë së institucionit.	2026
1.2.8	Politika për rekrutimin dhe pranimin e studentëve.	2026
1.2.9	Strategjia e kërkimit.	2026
1.2.10	Politika e vlerësimit të studentëve.	2026
1.2.11	Përmirësimi dhe plotësimi i kuadrit rregullator.	2026
1.2.12	Krijimi i organizmave të reja, Bordi i Partnerëve, Miqtë e UST-së.	2026
	<b>Objektivi i tretë: Krijimi i burimeve për sukses afatgjatë</b>	
1.3.1	Do të mbështesim zhvillimin e vazhdueshëm profesional të të gjithë stafit në mënyrë që ata të jenë efektivë në rolet e tyre aktuale dhe të zhvillohen e të përparojnë brenda institucionit tonë.	2026
1.3.2	Do të përgatisim personelin për rolet udhëheqëse dhe menaxheriale në fillim të karrierës së tyre në mënyrë që ata të kenë përvojën e gjerë të nevojshme për të marrë rolet me përgjegjësi më të madhe, me përkushtim të barabartë për ndërtimin e gjeneratës së ardhshme të shërbimeve akademike, profesionale.	2026
1.3.3	Sistemet tona të IT-se do të ofrojnë një shërbim që mbështet arsimin dhe hulumtimin.	2026
1.3.4	Ne do të mbështesim krijimin e hapësirave fizike dhe virtuale, të cilat janë të përshtatshme për mësimdhënie efektive, për të mësuar dhe për të mundësuar partneritetet tona.	2026
1.3.5	Do të sigurojmë një sistem të brendshëm të komunikimit që lejon stafin që të gjejë gjithçka që i nevojitet shpejt dhe të kryejë punën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive.	2026
1.3.6	Ndërtimi i një marke të fortë, të qëndrueshme dhe dalluese për Universitetit të Sporteve të Tiranës duke konsoliduar identitetin e tij akademik, profesional dhe publik si institucion referencë në nivel kombëtar dhe rajonal në fushën e sportit, edukimit fizik dhe të rehabilitimit.	2026-2031
	<b>Objektivi katër: Vendosja e studentëve në zemër të universitetit tonë dhe t'i bëjmë ata partnerë aktivë në edukimin e tyre</b>	
1.4.1	Krijimi i një sërë parimesh si bazë për punën e partneritetit ndërmjet studentëve dhe stafit.	2026
1.4.2	Përfshirja e studentëve në marrjen e vendimeve në lidhje me politikat dhe praktikatat e mësimdhënies dhe të nxënies.	2026
1.4.3	Kërkimi i feedback-ut nga studentët për përvojën e tyre arsimore, përgjigja dhe veprimi mbi bazën e saj.	2026
1.4.4	Mbështeten studentët për të marrë pjesë në jetën më të gjerë universitare dhe në komunitete të tjera.	2026

1.4.5	Bashkëpunimi me Këshillin e Studentëve për të ofruar një sërë aktiviteteve dhe mjedisesh sociale, sportive, artistike, kulturore dhe të tjera.	2026
1.4.6	Mbështetja dhe inkurajimi i studentëve të përfshihen plotësisht në jetën universitare përmes klubeve studentore dhe ngjarjeve akademike dhe sociale.	2026
1.4.7	Promovimi i aktiviteteve që bashkojnë grupe të ndryshme të studentëve.	2026
1.4.8	Mbështetja dhe inkurajimi i studentëve për vullnetarizëm dhe për të marrë pjesë në aktivitete të tjera brenda komuniteteve lokale.	2026
1.4.9	Sigurimi i ambienteve fizike dhe digjitale, të cilat i mbështesin studentët në pjesëmarrjen aktive në jetën universitare.	2026
1.4.10	Konsolidimi i qendrës për aktivitete jashtëkurrikulare për të siguruar aktivitete sportive, kulturore, artistike, sociale dhe vullnetare, për mësimin joformal të studentëve.	2026
	<b>Objektivi 5: Forma e Planit Financiar, Infrastruktura, burimet financiare, sistemi i informacionit</b>	
1.5.1	Do të mbrojmë burimet tona kryesore të të ardhurave dhe do të përmirësojmë konkurrencën përmes një përjasjeje të fokusuar dhe të orientuar drejt tregut për ofertën tonë arsimore.	2026
1.5.2	Do të përshtatim me shpejtësi portofolin tonë të programeve të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës	2026
1.5.3	Do të diversifikojmë dhe rritim të ardhurat tona përmes tarifave, kërkimit dhe shërbimeve akademike, partneriteteve e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare.	2026-2031
1.5.4	Do të ndërmarrim një qasje të menaxhuar dhe të planifikuar me kujdes në plotësimin e kësaj strategjie, duke udhëhequr me iniciativa për të përmirësuar kapacitetin, produktivitetin dhe efikasitetin për të arritur përfitime në fillim, duke gjeneruar burime financiare shtesë për realizimin e investimeve.	2026
1.5.5	Do të bashkëpunojmë me institucione të ndryshme për të patur mbështetje në financimin e projekteve madhore që kërkojnë shumë financim.	2026
1.5.6	Rikonstruksion i godinave, ambjenteve (projekte+rikonstruksione) për përmirësimin e kushteve dhe standarteve përkatëse, në shërbim të stafit dhe të studentëve,	2026
1.5.7	Fuqizimi i laboratorëve, plane konkrete më pajisje të standartizuara në shërbim të procesit kërkimor, shkencor, Blerja e paketës software për kontroll antiplagjaturë plagjaturë dhe pajisje mbështetese	2026

1.5.8	Përmirësimi i vazhdueshëm i auditoreve me pajisje, mjete kompjuterike, orendi zyre e pajisje të tjera ( pwr ambjentet ndihmwse tw Fushws sw Futbollit dhe ambjentet e tjera tw UST-sw).	2026
1.5.9	Investime, riparim i godinave, ambjenteve, terreneve sportive, palestrave, shtim i pajisjeve të ndryshme. Planifikime mujore në proces i nivelit të mirëmbajtjes të sallave të leksioneve, të kabineteve, klasave, të laboratorëve dhe i fasiliteve teknike.	2026-2031
1.5.10	Mirëmbajtje e infrastrukturës së sportit, si palestra, fushat e terrenet sportive, pajisjet e materialet didaktike për to.	2026
1.5.11	Investime të fuqishme në ndërtimin e mjediseve e terreneve sportive të nivelit bashkëkohor; pwrfundimi i Rikonstruksionit tw fushws së Futbollit Pistës së Atletikës dhe rrethimi nw UST, Studim projektim "Rikonstuksioni i palestres se gjimnastikes UST" dhe "Rikonstruksioni dhe rimodelimi i zyres se Rektorit UST"Rikonstruksion i palestrës së gjimnastikës, Fusha e Tenisit	2026-2027
1.5.12	Rritja e të ardhurave nga shërbimet e ndryshme për të tretët.	2026
1.5.13	Pasurimi i bibliotekës me libra, periodikë, dixhitalizimi i plotë i saj. Sigurimi i e-book.	2026
1.5.14	Mirëmbajtje e infrastrukturës TI në auditorë, laboratorë, biblioteka, sallat e teknologjisë, pajisja e pasurimi periodik me mjete didaktike e elektronike etj.	2026
1.5.15	Dixhitalizimi i Financës dhe Magazinës	2026
1.5.16	Përmirësimi i paisjeve shpërndarëse të internetit	2026
1.5.17	Përmirësimi periodik i rrjetit të brendshëm të shpërndarjes	2026
1.5.18	Plotësimi e rinovimi periodik i stafit akademik dhe administrativ me kompjuter dhe paisje të tjera ndihmëse	2026
1.5.19	Plotësimi i laboratorëve me paisje dhe programet (protokolle) përkatëse.	2026
1.5.20	Plotësimi dhe përditësimi i auditorëve me paisje kompjuterike dhe ndihmëse audio-vizive.	2026
<b>PRIORITETI STRATEGJIK 2: PËRMBUSHJA E STANDARTEVE AKADEMIKE TË PËRSOSMËRISË</b>		
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
<b>Objektivi i parë: Zhvillimi i kurrikulës</b>		
2.1.1	Hapja e programeve të reja të studimi në tre cikle studimi.	2026
2.1.2	Zbatimi i qasjeve të mëposhtme në zhvillimin e kurrikulave.	2026
2.1.3	Kurrikula e bazuar në kompetencë.	2026
2.1.4	Kurrikula e përqëndruar në student.	2026-2031
2.1.5	Kurrikula e bazuar në hulumtime.	2026-2031
2.1.6	Përditësimi i kurrikulave ekzistuese.	2026-2031
2.1.7	Fokusimi i pedagogëve për të shkruar rezultatet e të nxënit.	2026
2.1.8	Kodifikimin e kurrikulave dhe lëndëve në vijimësi të zhvillimeve.	2026
2.1.9	Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të kurrikulave.	2026
<b>VLERËSIMI I KURRIKULËS</b>		

	<b>Objektivi dy: Përsosmëri në mësimdhënie dhe të nxënit.</b>	
2.2.1	Konsolidimi e përditësimi i strukturave organizative dhe sigurimi i burimeve për të avancuar mësimdhënien dhe të nxënit me qëllim të krijimit, organizimit dhe mbështetjes së programeve dhe iniciativave që lidhen me mësimdhënien inovative dhe të nxënit ndërveprues.	2026-2031
2.2.2	Promovimi i gatishmërisë së pedagogëve për të përparuar në detyrat më sfiduese që hap mundësi për të përmirësuar, rritur performancën e universitetit.	2026
2.2.3	Rekrutimi i pedagogëve me një formim e nivel elitar për të qenë katalizatorë për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, mbështetjen e inovacionit dhe zhvillimin e të nxënit të avancuar në teknologji.	2026
2.2.4	Mbështetja e pedagogëve për të arritur potencialin e tyre të plotë përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm.	2026
2.2.5	Zhvillimi e përditësimi i metodologjive të mësimdhënies bazuar në qasjen mikse të të mësuarit dhe përmirësimi i aftësitë e tyre digjitale.	2026
2.2.6	Themelimi i një fondi për të mbështetur inovacionin që nxit mësimin aktiv dhe të angazhuar.	2026
2.2.7	Zbatimi i modeleve inovative të mësimit miks, si: kombinimi i mësimin në auditor dhe jashtë tij, përfshirja e mediave sociale, LMS etj.	2026
2.2.8	Përdorimi i feedback-ut mbi mësimdhënien për të njohur dhe promovuar pedagogët e shkëlqyer dhe për të vlerësuar cilësinë e programeve të mësuara.	2026
2.2.9	Zhvillimi i dokumentit të politikave për integritetin e hulumtimit të pedagogëve dhe studentëve dhe përdorimi i programit për zbulimin e plagjiaturës. Zhvillimi i platformës elektronike për vlerësimin e studentëve.	2026
	<b>Objektivi tre: Përsosmëri në jetën e studentëve</b>	
2.3.1	Zhvillimi i platformës për qasjen me në qendër studentin.	2026
2.3.2	Personalizimi i përvojave e të nxënit të studentëve.	2026
2.3.3	Promovimi, mbështetja dhe sigurimi i burimeve të nevojshme për mësimdhënien e grupeve të vogla.	2026
2.3.4	Dhënia e feedback-ut studentëve për përparimin dhe arritjen e tyre.	2026
2.3.5	Krijimi i hapësirave të mësimin, hulumtimit dhe hapësirave sociale që mbështesin një bashkësi akademike.	2026
2.3.6	Sigurimi i mundësive praktike për studentët në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	2026
2.3.7	Ofrimi i mundësisë për të gjithë studentët për të përmirësuar njohuritë dhe aftësitë e tyre në hulumtim, drejtim, internacionalizim dhe qëndrueshmëri në një gamë të gjerë fushash.	2026
2.3.8	Ofrimi i orientimit në karrierë dhe zhvillimi i aftësive të punësimit në një mënyrë që është e arritshme për të gjithë studentët gjatë gjithë kohës së tyre të studimit tek ne.	2026

2.3.9	Përqendrimi i aktiviteteve të rekrutimit dhe pranimit në përmirësimin e cilësisë së studentëve që aplikojnë dhe tërheqjen e studentëve më të mirë me potencial për të arritur përsosmërinë akademike.	2026
2.3.10	Zhvillimi i dokumentit të politikave për integritetin akademik të studentëve	2026
<b>PRIORITETI STRATEGJIK 3: KËRKIMI</b>		
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
<b>Objektivat për Kërkimin Shkencor</b>		
3.1	Përgatitja e strategjisë së kërkimit.	2026
3.2	Konsolidimi dhe përditësimi i profileve të hulumtimit të institucionit.	2026
3.4	Identifikimi periodik i projekteve kërkimore që kanë ndikim në zhvillimin e shoqërisë.	2026
3.5	Përgatitja periodike e paketës së projekteve kërkimore.	2026
3.6	Përdorim i të gjitha mundësive të financimit për të mbështetur kërkimet.	2026
3.7	Lidhja e hulumtimit me mësimdhënien.	2026
3.8	Konsolidimi dhe përditësimi i bazës së të dhënave për hulumtim.	2026
3.9	Vlerësimi i produktit kërkimor bazuar në metodologjinë matëse kombëtare dhe ndërkombëtare.	2026
3.1	Përgatitja e portofolit të kërkimit të institucionit.	2026
3.11	Zhvillimi dhe përditësimi i infrastrukturës kërkimore.	2026
3.12	Konsolidimi i rrjetit të studiuesve të rinj.	2026
3.13	Kryerja e hulumtimeve të nivelit të lartë duke sjellë risi për të mundësuar njohjen ndërkombëtare të universitetit.	2026
3.14	Zhvillimi i marrëdhënieve të reja kërkimore shkencore me institucionet e tjera akademike në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.	2026
3.15	Integrim më i mirë i UST-se në Zonën Evropiane të Kërkimit.	2026
3.16	Përdorimi i qasjes kurrikulare të bazuar në kërkime.	2026
3.17	Konsolidimi i Fondit të Studimit <i>Seedcom</i> për të mbështetur nismat e reja kërkimore.	2026
3.18	Sigurimi i një mbështetjeje financiare për pjesëmarrjen në aktivitetet kërkimore ndërkombëtare.	2026
<b>PRIORITET STRATEGJIK 4: NDËRTIMI I PARTNERITETIT</b>		
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
<b>Objektivi 1: Rritja e partneriteteve të jashtme për të mbështetur mësimdhënien dhe të nxënit, kërkimin dhe punësimin e studentëve</b>		
4.1.1	Përzgjedhja e partnerëve, pikat e forta dhe ambiciet e të cilëve janë në përputhje me tonat, për të rritur mundësitë e të nxënit të bazuar në përvojë dhe mundësitë e punësimit për studentët tanë.	2026
4.1.2	Garantimi që programet tona janë relevante për punëdhënësit dhe organizmat profesionale.	2026
4.1.3	Zgjerimi i mundësive të zhvillimit profesional për të mbështetur shkëmbimin e njohurive, ndërtimin e partneriteteve dhe gjenerimin e të ardhurave.	2026

	<b>Objektivi dy: Forcimi dhe rritja e numrit të partneriteteve kërkimore kombëtare dhe ndërkombëtare</b>	
4.2.1	Do të piketojmë dhe më pas do të zhvillojmë partneritetet që lidhen me pikat e forta dhe ambiciet tona kërkimore.	2026
4.2.2	Do të synojmë institucionet e arsimit të lartë me performancë më të lartë dhe partnerët kërkimore që lidhen dhe mbështesin pikat e forta të kërkimit tonë dhe mund të rrisin vlerën dhe ndikimin e hulumtimit.	2026
4.2.3	Do të miratojmë qasje të qëndrueshme për partnerët tanë, në aspektin e menaxhimit dhe shërbimeve të ofruara.	2026
4.2.4	Do të punojmë me drejtuesit dhe agjencitë e tyre, duke përfshirë financuesit e kërkimit, në një fazë të hershme për të ndihmuar në formulimin e të menduarit dhe për të arritur përfaqësim më të mirë në grupet punës dhe ekipet vendimmarrëse.	2026
4.2.5	Do të sigurohemi që skanimi i rregullt dhe i qëndrueshëm i horizontit është një element themelor i punës sonë për të kapur hulumtime të rëndësishme dhe relevante dhe mundësi më të gjera financimi sa më shpejt që të jetë e mundur.	2026
	<b>Objektivi i tretë: Zhvillimi i rrjeteve të forta të të diplomuarve të angazhuar që veprojnë si ambasadorë për ne, duke mbështetur arsimin dhe hulumtimin duke kontribuar me ekspertizë, rrjete dhe mbështetje financiare</b>	
4.3.1	Do të rrisim punën tonë me alumni, duke krijuar marrëdhënie dhe duke ndërtuar ndërgjegjësimin me studentët ndërkohë që ata studiojnë tek ne dhe në vijim.	2026
4.3.2	Do të evidentojmë ndikimin dhe aftësitë e alumni-t tonë për të mbështetur aktivitetin tonë kryesor të arsimit dhe kërkimit.	2026
4.3.2	Do të identifikojmë, hartojmë dhe ndjekim alumni-n tonë në mënyrë më efektive dhe do të sigurohemi që partneritetet tona me ta synojnë të përputhin interesat e tyre me prioritetet tona.	2026
	<b>PRIORITETI STRATEGJIK 5: NDËRKOMBËTARIZIMI</b>	
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
	<b>Objektivi i parë: Ndërkombëtarizimi i kurrikulës dhe i procesit të mësimdhënies dhe të nxënies dhe ofrimi i programeve dhe diplomave të përbashkëta</b>	
5.1.1	Ofrimi i mundësive në kurrikulën tonë formale dhe përvojën më të gjerë universitare i dimensionit ndërkombëtar.	2026
5.1.2	Sigurimi që të gjitha programet të shprehin qartë dimensionin ndërkombëtar dhe evropian.	2026
5.1.3	Konceptet kryesore të qytetarisë globale duhet të përfshihen në përvojën e të nxënies të studentëve tanë dhe parimet e drejtësisë shoqërore, ekologjisë qytetare, zhvillimit të qëndrueshëm, garës së drejtë, kohezionit me komunitetin dhe shkëmbimit global duhet të përshkojnë politikën dhe praktikën tona arsimore në të gjitha nivelet.	2026

5.1.4	Integrimi i kompetencave globale dhe ndërkulturore në kurrikula, sepse të mësuarit për të marrë pjesë në shoqëritë e ndërlidhura, komplekse dhe të ndryshme nuk është më luks, por domosdoshmëri e ngutshme.	2026
5.1.5	Identifikimi i elementeve kyç të ndërkombëtarizimit që mund të përfshihen në koleksionet e bibliotekave dhe në listat e leximit, burimet e medias.	2026
5.1.6	Zhvillimi i burimeve të mësimi elektronik për të mbështetur njësitë e arsimit ndërkombëtar dhe për të promovuar ndërgjegjësimin e çështjeve globale të arsimit.	2026
5.1.7	Ofrimi i programeve të përbashkëta me universitetet e huaja partnere në fushë.	2026
5.1.8	Ofrimi i programeve në gjuhë të huaja.	2026
	<b>Objektivi dy: Të zhvillohet lëvizshmëria e studentëve dhe shkëmbimeve të stafit</b>	
5.2.1	Promovimi dhe mbështetja e mundësive ndërkombëtare për studentët, duke përfshirë mundësitë afatshkurtra për studentët tanë për të studiuar në universitetet partnere, për internshipet ndërkombëtare dhe shkollat verore.	2026
5.2.2	Promovimi i mundësive për shkëmbimin e studentëve të ofruar nga Programet e Bashkimit Evropian, si Erasmus +, Programet e Përbashkëta Master, Partneritetet Erasmus Mundus, programet dypalëshe të vendeve ose programe të tjera ndërkombëtare.	2026
5.2.3	Ofrimi i mundësive për zhvillimin e stafit universitar për aktivitetet ndërkombëtare që ndihmojnë në rritjen e ndërgjegjësimi ndërkombëtar dhe integrimin e çështjeve globale në programin dhe pedagogjinë tonë.	2026
5.2.4	Zgjerimi me staf ndërkombëtar dhe programe shkëmbimi të studentëve (në baza reciproke) dhe sponsorizimi i pedagogëve vizitorë/ kërkuesve vizitorë.	2026
5.2.5	Ngritja e një baze të dhënash që përmban informacion mbi stafin ekzistues ndërkombëtar dhe lidhjet institucionale dhe identifikimi i burimeve të financimit dhe mundësive strategjike.	2026
5.2.6	Krijimi i një funksioni këshillimor ndërkombëtar që u ofron stafit informacionin, trajnimin dhe mbështetjen që ata kanë nevojë për të zhvilluar ekspertizën ndërkombëtare përmes projekteve, kurseve dhe përfaqësimit. Paralelisht me këtë, duhet të ketë një funksion këshillimor ndërkombëtar në kuadër të zyrës së mbështetjes së studentëve për studentët tanë që kërkojnë të studiojnë jashtë vendit dhe studentët e ardhshëm ndërkombëtarë që kërkojnë qasje në programet e UST-së.	2026
	<b>Objektivi i tretë: Përparimi i partneriteteve akademike ndërkombëtare dhe projektet e përbashkëta kërkimore-shkencore</b>	
5.3.1	Përzgjedhja e botimeve, revistave, konferencave dhe rrugëve të tjera të botimit që kanë të bëjnë me arsimin ndërkombëtar.	2026
5.3.2	Organizimi i të paktën një kërkimi ndërkombëtar dhe një konferencë ndërkombëtare në vit.	2026
5.3.3	Zgjerimi i lidhjeve me partnerët e hulumtimit strategjik nëpërmjet rrjeteve.	2026

5.3.4	Krijimi i një strategjie të koordinuar rajonale për të mundësuar partneritete strategjike afatgjata ndërkombëtare që mbështesin kërkimet dhe shkëmbimin e njohurive.	2026
5.3.5	Inkurajimi dhe mbështetja e departamenteve tona dhe ekipeve kërkimore për të zhvilluar bashkëpunime të fuqishme ndërkombëtare për të mbështetur kërkime me cilësi të lartë.	2026
5.3.6	Alokimi i burimeve në mënyrë që të përfshihet komuniteti hulumtues i UST-së në projektet kërkimore ndërkombëtare.	2026
5.3.7	Anëtarësimi në shoqatat ndërkombëtare të kërkimit.	2026
	<b>Objektivi katër: Të krijojmë mjedis për rekrutimin e studentëve ndërkombëtarë</b>	
5.4.1	Tërheqja e studentëve ndërkombëtarë dhe mbështetja më e mirë siguar që ata të bëhen pjesë e komunitetit tonë, duke ndarë njohuritë, duke ofruar aftësitë që ata kanë nevojë për t'u punësuar dhe duke krijuar mundësi për marrëdhënie dhe rrjete gjatë gjithë jetës.	2026
5.4.2	Eksplorimi i fushave të programeve që u interesojnë studentëve të huaj.	2026
5.4.3	Rekrutimi i më shumë studentëve ndërkombëtarë në programet e ciklit të dytë dhe të tretë ose në zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe programet kërkimore.	2026
5.4.4	Zhvillimi i të mësuarit online dhe të avancuar në teknologji për të ndërtuar bashkësi ndërkombëtare të studentëve në programet bachelor dhe master.	2026
5.4.5	Integrimi i studentëve ndërkombëtarë në komunitetin e UST-së.	2026
<b>PRIORITETI STRATEGJIK 6: SIGURIMI I CILËSISË</b>		
Nr.	Veprimet	Afati i realizimit
	<b>Objektivi i parë: Të gjitha standardet e cilësisë duhet të përmbushen përmes proceseve të</b>	
6.1	Promovimi i kulturës së cilësisë sipas të cilës çdo anëtar i komunitetit të institucionit e sheh dhënien dhe përmirësimin e cilësisë si përgjegjësi personale dhe kolektive.	2026
6.2	Zhvillimi i politikave, procedurave, proceseve që mbështesin një plan efektiv të planifikimit, zbatimit, monitorimit, vlerësimit dhe përmirësimin, duke marrë parasysh kontekstin e brendshëm dhe të jashtëm.	2026
6.3	Paraqitja e një tabloje të cilësisë në institucionin, njësinë kryesore dhe nivelin e njësisë bazë. Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve institucionale.	2026
6.4	Identifikimi dhe analiza e pikave të forta dhe të dobëta të veprimtarisë së përgjithshme të institucionit, të njësive kryesore dhe njësive bazë që veprojnë brenda institucionit.	2026
6.5	Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve të programeve studimore.	2026
6.6	Monitorimi dhe vlerësimi i cilësisë së përgatitjes së studentëve.	2026
6.7	Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve kërkimore shkencore.	2026

6.8	Monitorimi dhe vlerësimi i përmbushjes së standardeve profesionale nga stafi akademik dhe stafi administrativ.	2026
6.9	Nxitja e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, administrativ dhe studentëve për të reflektuar.	2026
6.1	Monitorimi vlerësimi i cilësinë e shërbimeve të UST-së që u ofrohen studentëve.	2026
6.11	Monitorimi dhe vlerësimi i menaxhimit të burimeve financiare.	2026
6.12	Propozimi i një plani veprimi për të sjellë përmirësim, ndryshim, zhvillim.	2026
6.13	Ofrimi i informacionit që do të shërbejë për vlerësimin dhe akreditimin e jashtëm.	2026
	<b>Objektivi dy: Të krijojë sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
6.2.1	Konsolidimi i Komisionit të Sigurimit të Cilësisë.	2026
6.2.2	Konsolidimi i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.	2026
6.2.3	Trajnimi i vazhdueshëm i ekipit të sigurimit të brendshëm të cilësisë.	2026
6.2.4	Identifikimi i përgjegjësive funksionale të organeve dhe autoriteteve përgjegjëse për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet.	2026
6.2.5	Trajnimi i stafit për sigurimin e brendshëm të cilësisë.	2026
6.2.6	Zhvillimi i vlerësimit të personelit akademik nga kolegët.	2026-2031